



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E TIRANËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

[Dt.17.01.2023]

**OPERATORIT EKONOMIK “A-T-D - ALBANIAN TECHNOLOGY
DISTRIBUTION” SHPK**

Adresa: Rr. Pjeter Bogdani, P36/1, Ap10 Tiranë AL, 1019

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar.**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]* **“Rritja e aksesit në informacion dhe shërbime nëpërmjet teknologjisë së inovacionit” me Nr. reference REF-52980-12-12-2022** për nevoja të Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë.

Publikimet e mëparshme (*njoftimi i kontratës*): Buletini Nr. 173 datë 19 Dhjetor 2022

Publikimet e mëparshme (*njoftimi i fituesit paraprak*): Buletini Nr. 4 datë 16 Janar 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara.

- **Operatori ekonomik “INSTANT.AL” sh.p.k, NIPT L81506043D**

Vlera e ofertës pa tvsh = 2,649,999 (dy milion e gjashtëqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.

- **Operatori ekonomik “FASTECH” sh.p.k, NIPT J81609010U**

Vlera e ofertës pa TVSH– 3,150,000 (tre milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

- **Operatori ekonomik “A-T-D - ALBANIAN TECHNOLOGY DISTRIBUTION” sh.p.k, NIPT L21811033B**
- Vlera e ofertës pa tvsh = 3,205,000 (tre milion e dyqind e pesë mijë) lekë.

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- **Operatori ekonomik “INSTANT.AL” sh.p.k, NIPT L81506043D**

Për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82 pika 4 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi si vijon:

- I. Në pikën 2.3.5 të Kapacitetit teknik dhe profesional pjesë e Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, AK kërkon:

... “2.3.5 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka në stafin teknik punonjës të diplomuar në degët: Informatikë, Teknologji Informacioni, Elektronikë ose ekuivalente, që do të angazhohen në implementimin e kontratës, me kompetencat minimalisht si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti (PMP / PRINCE2) ose ekuivalente.
- b) Të paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar për "ITIL Foundation" ose ekuivalente.
- c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në fushën e sigurisë së sistemeve të informacionit.
- d) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për administrimin e bazës së të dhënave.
- e) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për "Softëare Business Analyst" ose ekuivalente.
- f) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si Microsoft Certified Professional Developer ose ekuivalente.
- h) Të paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar si Microsoft Certified Application Developer per Microsoft .NET.

Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikime sipas kërkesave më sipër.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- *Certifikata/ Transkriptet përkatëse për specialistët e kërkuar;*
- *Diplomat ose vërtetime nga universitetet përkatëse.*
- *Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B;*

- *Listëpagesat sipas formularit eSig-25 për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B.*

Kriteri 2.3.5 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit...”

Operatori ekonomik “INSTANT.AL” sh.p.k në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në sesionin “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” ka deklaruar:

Profili i punonjësve: Programues, zhvillues softëare, ëbmaster etj.

Operatori ekonomik “ONI” sh.p.k ka deklaruar:

Profili i punonjësve:

Inxhnier elektronik

Inxhinier mekanik

Inxhinier informatik

Inxhinier IT

Inxhinier informaticien

Inxhinier Informatik (programues)

Inxhinier Elektronik, Informatik për mirëmbajtjen e kompjuterave

Inxhinier Elektronik, Informatik për infrastrukturën e rrjetit.

Informaticien ose Inxhinier Informatik (programues).

Punonjës të diplomuar në shkenca elektronike, në shkenca kompjuterike, në shkenca informatike dhe specialiste të certifikuar për CCNA, për CCNP, PROGRAMUES/ZHVILLUES, specialist të certifikur për DATA BAZE, për Softëare Development fundamentals, Database Fundamentals etj,

Softëare Development Fundamentals

Database Fundamentals

Health Information Exchange Certified Developer

CISCO CERTIFIED NETWORK ASSOCIATE ROUTING AND SWITCHING- CCNA

CISCO CERTIFIED NETWORK PROFESSIONAL ROUTING AND SWITCHING- CCNP”

Për përmbushjen e kriterit të sipërcituar, Operatori Ekonomik “INSTANT.AL” sh.p.k dhe subjekti mbështetës në **burime njerëzore** “ONI” sh.p.k, nuk kanë deklaruar personelin teknik të angazhuar (listën emërore përkatëse) sipas kërkesave të kriterit, nuk kanë deklaruar llojin e certifikimeve dhe diplomimeve që disponon stafi përkatës si dhe eksperiencat respektive të kërkuara. Gjithashtu, referuar informacionit të paraqitur në sesionin “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” të Formularëve Përmbledhës të Vetëdeklarimit , nuk deklarohet në asnjë formë, nga asnjëri prej operatorëve ekonomik se disponojnë staf të certifikuar sipas kërkesave:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti (PMP / PRINCE2) ose ekuivalente.*
- b) Të paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar për "ITIL Foundation" ose ekuivalente.*
- c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në fushën e sigurisë së sistemeve të informacionit.*
- e) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për "Softëare Business Analyst" ose ekuivalente.*

Operatori ekonomik ofertues “INSTANT.AL” sh.p.k ka deklaruar profilin e punonjësve në mënyrë të përgjithësuar “Programues, zhvillues softëare, ëbmaster etj”, dhe nuk ka deklaruar profilin e diplomave të stafit sipas kërkesave të kriterit, nuk ka deklaruar nëse stafi i profilizuar si më sipër disponon certifikime, tipologjinë përkatëse të certifikatave që do t’i shërbente AK për të vërtetuar përputhshmërinë me kërkesat e kriterit, nuk ka përcaktuar dhe listën emërore të stafit të angazhuar, informacione këto shumë të rëndësishme për AK që shërbejnë jo vetëm për të krijuar bindjen se OE është i aftë të kryejë shërbimin objekt kontrate i cili është voluminoz, afatgjatë dhe me një rëndësi të veçantë për AK, por edhe të domosdoshme për verifikimin e dokumentacionit provues përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit, nëse OE do të kualifikohet në vend të parë.

Në vijim të arsyetimit, argumentojmë gjithashtu se:

Në zbatim të nenit 90 pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” citohet:

“Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

....

- *Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor...”*

Referuar citimit si më sipër dhe referuar informacionit të paraqitur në sesionin “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ofertues “INSTANT.AL” sh.p.k , meqënëse ky i fundit nuk ka specifikuar se cilat prej shërbimeve merr përsipër të realizojë nëpërmjet deklarimit të informacionit për specialistët e certifikuar e diplomuar, AK nuk mund të gjykojë nëse “INSTANT.AL” sh.p.k, plotëson të paktën 50 % të kërkesave të **përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor, konkretisht për kërkesat e stafit sipas kriterit 2.3.5 të DST.**

Gjithashtu, në vijim të gjykimit, theksojmë se:

Në kontratën e bashkëpunimit të paraqitur, datë 01.10.2022, të nënshkruar ndërmjet Operatorit ekonomik ofertues “INSTANT.AL” sh.p.k dhe subjektit mbështetës “ONI” sh.p.k, citohet se Operatori Ekonomik “INSTANT.AL” sh.p.k zotëron në stafin e saj punonjës të kualifikuar/certifikuar në:

- PHP,HTML CSS and XHTML
- Teknologji informacioni IT dhe Administrim Rrjeti
- etj

Bazuar në këtë informacion, krijohet bindja që Operatori Ekonomik “INSTANT.AL” sh.p.k ndodhet para faktit se me kualifikimet e stafit të cituar në këtë kontratë nuk është kurrësi në përputhje me kërkesat e cituara në VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” , neni 50, pika 2.

II. Në Formularin e Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit shtojca 8 e DST citohet:

.... Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës....

Në nenin 82 pika 1 e ligjit nr.162/2022 “Për prokurimin publik” citohet:

*...”Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni **që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm...**”*

Operatori Ekonomik “ONI” sh.p.k, subjekti mbështetës i operatorit ekonomik ofertues ka paraqitur “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit” i cili mban datë dorëzimi të deklaratës 31.10.2022.

Referuar sa më sipër, bazuar në datën e dorëzimit të deklaratës (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit) së subjektit mbështetës “ONI” sh.p.k, nuk vërtetohet përmbushja e kriterëve të DST në datën e hapjes së ofertës (23.12.2022), konkretisht:

1. *Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe **kontributet e sigurimeve shoqërore**, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. (pjesë e deklaratës për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit pjesa II: Shkaqet e përjashtimit të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit)*
2. *Listëpagesat sipas formularit eSig25 për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B, (pjesë e kërkesave të kriterit 2.3.3 të kapacitetit teknik dhe profesional).*

Në datën 31.10.2022, të deklaratës së paraqitur nuk vërtetohet **shlyerja e detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe Listëpagesat sipas formularit eSIG për muajin e fundit të kërkuar**, pra për muajin nëntor 2022, Detyrimet për Taksat dhe Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Listëpagesat sipas formularit eSig25 duhet të deklarohen për muajin Nëntor 2022, sipas kërkesave të legjislacionit përkatës, Ligji Nr. 9136, datë 11.9.2003 (i ndryshuar) “Për Mbledhjen e Kontributeve të Detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shendetësore në Republikën e Shqipërisë”, Neni 11.

Në vijim të arsytimit, KVO gjykon se operatori ekonomik “INSTANT.AL” sh.p.k, nuk ka përmbushur kërkesat sipas 2.3.5 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit të Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST) dhe Operatori Ekonomik mbështetës “ONI” sh.p.k nuk ka përmbushur kriterin e “Detyrimeve për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore” (pjesë e deklaratës për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit pjesa II: Shkaqet e përjashtimit të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit).

- **Operatori ekonomik “FASTECH” sh.p.k, NIPT J81609010U**

Për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82 pika 4 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi si vijon:

I. Në pikën 2.3.1 të Kapaciteti teknik dhe profesional pjesë e Kritereve të Vecanta të Kualifikimit, AK kërkon:

”2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe **faturave tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”

Operatori ekonomik “FASTECH” sh.p.k, nuk ka paraqitur dokumentacion vërtetues sipas kërkesave të kriterit, konkretisht nuk ka paraqitur faturat tatimore të shitjes për përvojën e mëparshme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**A-T-D - ALBANIAN TECHNOLOGY DISTRIBUTION**” sh.p.k, NIPT L21811033B, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 3,205,000 (tre milion e dyqind e pesë mijë) lekë pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë me adresë Bllv “Dëshmorët e Kombit”*, Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JOX

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____